4.	Shtetësia 01	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
5.	Përqindja e aksioneve 01	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
6.	Gjinia 01	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
7.	Aksionar 02	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
8.	Shtetësia 02	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
9.	Përqindja e aksioneve 02	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
10.	Gjinia 02	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
11.	Aksionar 03	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
12.	Shtetësia 03	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
13.	Përqindja e aksioneve 03	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
14.	Gjinia 03	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
15.	Aksionar 04	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
16.	Shtetësia 04	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
17.	Përqindja e aksioneve 04	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
18.	Gjinia 04	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
19.	Aksionar 05	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
20.	Shtetësia 05	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
21.	Përqindja e aksioneve 05	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
22.	Gjinia 05	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
23.	Emri i shoqërisë	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
24.	Statusi	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
25.	Forma ligjore	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
26.	Aktiviteti	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
27.	Prona	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
28.	Kodi i aktivitetit	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
29.	Përshkrimi i aktivitetit	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
30.	Adresa kryesore	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
31.	Adresat sekondare	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
32.	Bashkia	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
33.	Rajoni	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
34.	Qytet/fshat	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
35.	Emri tregtar	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit
36.	Numri i certifikatës	Regjistri tregtar	*eRegister*	Qendra Kombëtare e Biznesit

VENDIM
Nr. 78, datë 5.2.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 519, DATË 20.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 519, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Sekretariati teknik i KKTU-së zbardh vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar. Vendimet nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretarit të KKTU-së. Vendimet, pasi nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

Në rastin e zbardhjes së vendimeve, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, sekretariati teknik koordinon veprimet me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet për dhënie lejeje apo autorizimi, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet, pasi nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe, kur është rasti, edhe nga sekretari i KKTU-së, hyjnë në fuqi menjëherë.".

2. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 79, datë 5.2.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 702, DATË 4.11.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV, VALIAS'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 702 datë 4.11.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera "1 728 384 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekësh" zëvendësohet me "7 029 267 (shtatë milionë e njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh".

2. Tabela bashkëlidhur vendimit nr. 702, datë 4.11.2022, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 80, datë 5.2.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 788, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLAT E DETAJUARA PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN E SHPËRBLIMIN FINANCIAR TË KOMISIONIT QENDROR TË STATUSIT 'DËSHMOR I ATDHEUT'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 5, të nenit 10, të ligjit nr. 109/2018, "Për statusin e dëshmorit të atdheut", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 788, datë 11.12.2019, Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen dhe rregullat e detajuara për organizimin, funksionimin e shpërblimin financiar të Komisionit Qendror të Statusit 'Dëshmor i atdheut"', bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

i. Në shkronjën "a", pas fjalëve "... të dërguar ..." shtohen "... përmes portalit *"e-Albania*" ...";

ii. Në shkronjën "b", pas fjalës "... kërkuese ..." shtohen fjalët "... të dërguara përmes portalit "*e-Albania*" ...";

iii. Në shkronjën "c", fjalët "... me shkrim ..." zëvendësohen me "... përmes portalit "*e-Albania*" ...;

iv. Në shkronjën "ç", pas fjalës "... njofton ..." shtohen fjalët "... përmes portalit "*e-Albania*" ...";

v. Në shkronjën "g", fjalët "... me shkresë zyrtare ..." zëvendësohen me "... përmes portalit "*e-Albania*" ...".

b) Në pikën 5, fjalët "... i paraqitet ..." zëvendësohen me "... i dërgohet nëpërmjet portalit "*e-Albania*" ...".

c) Në fund të pikës 6, shtohen fjalët "... nëpërmjet portalit "*e-Albania*".

ç) Në pikën 7, pas fjalëve "... këshillit të qarkut, këshillit bashkiak dhe prefektit." shtohen "... nëpërmjet portalit "*e-Albania*.".

d) Pas pikës 9 shtohet pika 9.1, me këtë përmbajtje:

"9.1 Deri në momentin e krijimit të infrastrukturës së nevojshme teknike për ofrimin e shërbimeve përmes portalit "*e-Albania*", pritja dhe trajtimi i aplikimeve do të vijojë të kryhet sipas mënyrave dhe mjeteve ekzistuese.".

dh) Kudo në tekstin e vendimit, fjala "propozimi/propozimin/propozimit" zëvendësohet përkatësisht me "kërkesa / kërkesën / kërkesës" dhe fjala "propozues / propozuese" zëvendësohet përkatësisht me "kërkues/kërkuese".

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Komisioni Qendror i Statusit "Dëshmor i atdheut" dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 82, datë 5.2.2025

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2025, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2025.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
PEMA E PROGRAMIT TË ASHK-së PËR VITIN 2025



SHTOJCA NR. 2
BUXHETI I AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS 2025

000/lekë

PËRSHKRIMI	Buxheti 2025	
	Të Ardhura	Shpenzime
Të ardhura nga Shërbimet +Parcela ndertimore+Të tjera	4,534,460	
Te ardhura nga buxheti i shtetit	1,577,329	
Shpenzime personeli		2,837,844
Shpenzime korrente		612,167
Shpenzime kapitale nga e cila:		1,964,337
Për projektet e regjistrimit fillestar të ZK dhe digjitalizimi i të dhënave kadastrale		1,577,329
Fondi rezervë		104,700
Total ASHK	**6,111,789**	**5,519,048**
Të ardhura të pashpërndara ASHK (Te ardhura - Shpenzime)		**592,741**

SHTOJCA NR. 3
BUXHETI I AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS 2025

000/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti 2025
I	**TOTALI I TË ARDHURAVE**	**6,111,789**
1	Të ardhura nga shërbimet	2,230,000
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	350,000
3	Të ardhura të tjera	200,000
4	Fonde që trashëgohen nga viti 2024	1,754,460
I-1	**Fonde te transferuara nga buxheti i shtetit**	**1,577,329**
II	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**5,519,048**
1	**Shpenzime personeli**	**2,837,844**
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar + QKD	1,771,751
2	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjesit në organikë	294,839
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	584,975
4	Kontribute për Sigurime Shoqerore për punonjësit me kontratë	97,691
5	Fondi i vecantë i pagave	88,588
2	**Shpenzime operative**	**612,167**
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime + QKD	612,167
3	**Shpenzime Kapitale**	**1,964,337**
a	**Investime kapitale të patrupëzuara**	**1,672,455**
1	Shpenzime për investime të patrupëzuara	95,126
2	Regjistrimi fillestar për 106 ZK	833,796
3	Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme	743,533
b	**Investime kapitale të trupëzuara**	**291,882**
1	Rikonstruksione (Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+Vlore etj)	191,882
2	Blerje pajisje elektronike	70,000
3	Orendi	30,000
III	**Fondi Rezervë**	**104,700**
1	Fondi Rezervë	104,700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME(te ardhura te pashperndara)	**592,741**

VENDIM
Nr. 84, datë 5.2.2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1497, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për shtypjen e letrave me vlerë", të ndryshuar, në pikën 2.1, pas fjalëve "... shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a., ..." shtohen "... , vetë ose nëpërmjet një shoqërie të krijuar prej saj, ...".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 85, datë 5.2.2025

PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË DISIPLINËS DHE TË KOMISIONIT TË APELIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 123/2014, "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton rregullat për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës pranë Urdhrit të Mjekëve dhe Komisionit të Apelimit pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit, duke siguruar një proces të rregullt ligjor për shqyrtimin e pretendimeve për shkelje disiplinore dhe zbatimin e masave disiplinore, në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin shëndetësor.

3. Ky vendim zbatohet për mjekët që ushtrojnë profesionin në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike në Republikën e Shqipërisë.

4. Organet disiplinore, sipas ligjit, janë "Komisioni i Disiplinës", që ngrihet dhe funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve, si edhe "Komisioni i Apelimit", që ngrihet dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

II. KOMISIONI I DISIPLINËS

1. Komisioni i Disiplinës funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët kanë përvojë në fushën e mjekësisë ose në fushën juridike, si më poshtë vijon:

a) 3 (tre) përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, me përvojë apo specializim në çështje të etikës dhe të deontologjisë mjekësore;

b) 1 (një) përfaqësues i emëruar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, me njohuri në fushën shëndetësore ose në procedurat administrative;

c) Shefi i shërbimit të specialitetit të mjekut, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen.

2. Kryetari i Komisionit të Disiplinës miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve.

3. Për të qenë anëtar i Komisionit të Disiplinës kërkohet që ai të përmbushë kushtet e integritetit profesional, të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë në profesionin e tyre dhe të mos ketë masa disiplinore të mëparshme ose rekorde, që cenojnë integritetin dhe objektivitetin e procesit.

4. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Disiplinës është 2 (dy) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata qëndrojnë në detyrë deri në caktimin e anëtarit pasardhës.

5. Anëtari i Komisionit të Disiplinës heq dorë ose përjashtohet nga ky komision, sipas parashikimeve që rregullojnë pengesat ligjore, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në rast largimi të parakohshëm të ndonjë anëtari, organi i emërtesës emëron një anëtar të ri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Anëtari i ri qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të paraardhësit.

7. Komisioni i Disiplinës funksionon si organ kolegjial, me të paktën 3 (tre) anëtarë dhe merr vendime me shumicë të thjeshtë votash.

8. Komisioni i Disiplinës shqyrton ankesat në lidhje me veprimet e kryera nga mjekët gjatë ushtrimit të detyrës, që bien ndesh me parimet e etikës profesionale apo Kodin e Deontologjisë Mjekësore.

9. Ankesa/kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor ndaj mjekut, në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar, të plotësojë këto kushte:

a) të jetë me shkrim;

b) të identifikojë mjekun, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore, dhe rrethanat e kryerjes së tij.

10. Ankesat anonime nuk pranohen për shqyrtim.

11. Komisioni i Disiplinës fillon kryesisht procedimin disiplinor për mjekun, ndaj të cilit është regjistruar një procedim penal, për të cilin vihet në dijeni institucioni shëndetësor ose Urdhri i Mjekëve.

12. Brenda 5 (pesë) ditëve nga regjistrimi i kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, kryetari i Komisionit të Disiplinës njofton mbledhjen e këtij komisioni.

13. Komisioni i Disiplinës asistohet nga sekretariati teknik, i cili verifikon nëse kërkesa i plotëson kushtet formale të parashikuara në pikën 9, të kreut II, të këtij vendimi, dhe përgatit një relacion me shkrim për komisionin.

14. Kërkesa që nuk plotëson këto kritere konsiderohet e metë. Komisioni i Disiplinës njofton kërkuesin/iniciuesin e procedimit disiplinor me shkrim, duke i caktuar një afat, jo më shumë se 7 (shtatë) ditë për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se të metat plotësohen brenda afatit të caktuar, afati për fillimin e procedimit disiplinor do të konsiderohet data e plotësimit të këtyre të metave.

15. Në rast se konstatohet mosplotësim i kritereve formale, kryetari i Komisionit të Disiplinës merr vendim për mospranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor.

16. Nëse ankesa e depozituar plotëson kushtet formale, të parashikuara në pikën 9, të këtij kreu, Komisioni i Disiplinës merr vendim për fillimin e hetimit disiplinor dhe njofton mjekun për fillimin e procedimit. Afati i përfundimit të procedimit disiplinor është 30 (tridhjetë) ditë dhe fillon të ecë nga momenti që merr vendim për fillimin e hetimit disiplinor.

17. Komisioni i Disiplinës heton e gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara e të seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit të Mjekëve, subjekt i procedimit disiplinor.

18. Komisioni i Disiplinës mbledh dhe verifikon çdo dokumentacion të nevojshëm, që ka lidhje me çështjen, objekt hetimi, dhe nëse e konsideron të nevojshme, thërret për dëshmi mjekun e akuzuar, pacientin (ose përfaqësuesin e tij ligjor), familjarët apo të afërm të tjerë të pacientit, si edhe çdo person tjetër që vlerësohet se ka informacion të rëndësishëm për hetimin.

19. Kur çështja kërkon ekspertizë specifike, Komisioni i Disiplinës, nëse e konsideron të nevojshme, kërkon mendimin e specialistëve të fushës mjekësore përkatëse për të vlerësuar veprimet e mjekut që po procedohet, në përputhje me standardet, udhëzimet e njohura profesionale, si edhe protokollet mjekësore. Po kështu, kërkon informacione shtesë nga institucione të tjera shëndetësore, autoritete rregullatore dhe organe profesionale për të siguruar të dhëna plotësuese të rëndësishme për hetimin.

20. Komisioni i Disiplinës ka të drejtë të kryejë inspektime në vendet e punës, ku mjeku ushtron veprimtarinë mjekësore, për të vlerësuar kushtet e punës, pajisjet e respektimin e standardeve profesionale dhe etike të kërkuara.

21. Komisioni i Disiplinës përgatit një raport të plotë me përshkrimin e procesit hetimor, gjetjeve, dëshmive dhe rekomandimeve, i cili përfshihet në dosjen disiplinore të mjekut dhe u njoftohet edhe palëve të tjera, pjesëmarrëse në këtë procedim.

22. Në rast se në përfundim të hetimit disiplinor vërtetohet se nuk ka shkelje disiplinore, atëherë Komisioni i Disiplinës merr vendim për ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

1.23. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore ose ka bërë shkelje të tjera, Komisioni i Disiplinës jep një nga masat disiplinore, të parashikuara nga neni 17, i ligjit nr. 123/2014, "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

24. Në përfundim të procedimit disiplinor, Komisioni i Disiplinës merr vendim të arsyetuar, i cili i njoftohet mjekut, subjekt i procedimit disiplinor. Vendimi përfundimtar i organit disiplinor përmban këto të dhëna:

a) organin që ka marrë vendimin;

b) identifikimin e mjekut ndaj të cilit është marrë masa;

c) bazën ligjore;

ç) shkeljen faktike;

d) masën e marrë;

dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve, që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;

e) të drejtën dhe afatin e ankimimit ndaj vendimit të Komisionit të Disiplinës.

25. Vendimet e Komisionit të Disiplinës ankimohen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i arsyetuar në Komisionin e Apelimit, që ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

III. KOMISIONI I APELIMIT

1. Komisioni i Apelimit ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me të drejtë rizgjedhjeje, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) përfaqësues të zgjedhur nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

b) 1 (një) përfaqësues i zgjedhur nga Urdhri i Mjekëve;

c) 1 (një) përfaqësues i zgjedhur nga Fakulteti i Mjekësisë;

ç) 1 (një) ekspert i jashtëm, i specialitetit të mjekut, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen.

2. Komisioni i Apelimit shqyrton ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të Disiplinës dhe siguron një vlerësim të pavarur, duke përfshirë seanca dëgjimore dhe mbledhje provash të nevojshme.

3. Për të qenë anëtar të Komisionit të Apelimit që ai kërkohet të përmbushë kushtet e integritetit profesional, të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë në profesionin e tyre dhe të mos ketë masa disiplinore të mëparshme ose rekorde që cenojnë integritetin dhe objektivitetin e procesit.

4. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Apelimit është 2 (dy) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. Ata qëndrojnë në detyrë deri në caktimin e anëtarit pasardhës.

5. Anëtari i Komisionit të Apelimit heq dorë ose përjashtohet, sipas parashikimeve që rregullojnë pengesat ligjore, të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në rast largimi të parakohshëm të ndonjë anëtari, organi i emërtesës emëron një anëtar të ri brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Anëtari i ri qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të paraardhësit.

7. Komisioni i Apelimit funksionon si organ kolegjial, me të paktën 3 (tre) anëtarë dhe merr vendime me shumicë të thjeshtë votash.

8. Çdo akt drejtuar Komisionit të Apelimit vlerësohet si ankim edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë, por del nga përmbajtja e këtij akti dhe është mjaftueshëm i qartë. Ankimi paraqitet në formë të shkruar dhe përmban:

a) adresimin e ankesës në Komisionin e Apelimit;

b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit të tij, në rastin e personave fizikë;

c) vendimin e Komisionit të Disiplinës, kundër të cilit paraqitet ankimi;

ç) parashtrimin e objektit dhe shkaqeve të ankimit;

d) aktet procedurale, të cilat i bashkëlidhen ankimit, të tilla si:

i. akti i përfaqësimit, në rast se ankimi paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur i ankuesit;

ii. kopje të vendimit të Komisionit të Disiplinës, objekt ankimi;

iii. dokumente, prova apo materiale të tjera që shoqërojnë ankimin, në origjinal ose të njësuara me origjinalin;

dh) nënshkrimin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij, në rast se ankimi paraqitet prej këtij të fundit, sipas tagrave të dhënë shprehimisht në aktin e përfaqësimit.

9. Komisioni i Apelimit asistohet nga sekretariati teknik, i cili verifikon nëse ankimi plotëson kriteret formale të parashikuara më sipër. Ankimi që nuk plotëson këto kritere konsiderohet i metë. Kryetari njofton ankuesin me shkrim, duke i caktuar një afat 7-ditor për plotësimin e të metave të konstatuara. Në rast se ankuesi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, Komisioni i Apelimit vendos mospranimin e ankimit.

10. Komisioni i Apelimit në çdo rast nuk ka të drejtë t'ia kthejë për rishqyrtim ankesën Komisionit të Disiplinës.

11. Komisioni i Apelimit, në përfundim të shqyrtimit të ankimit, vendos:

a) mospranimin e ankimit;

b) pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Disiplinës;

c) ndryshimin e masës disiplinore, dhënë nga Komisioni i Disiplinës në një masë më të lehtë.

12. Vendimi i Komisionit të Apelimit në çdo rast është i arsyetuar.

13. Vendimet e marra nga Komisioni i Apelimit publikohen, në mënyrë të anonimizuar, në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe të Urdhrit të Mjekëve.

14. Kundër vendimit të Komisionit të Apelimit lejohet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni për vendimin.

15. Ankimi në gjykatë nuk pezullon zbatimin e vendimit të Komisionit të Apelimit.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Disiplinës marrin shpërblim, sipas përcaktimeve në vendimet e Këshillit Kombëtar për pagesat dhe honorarët e komisioneve të përhershme pranë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

2. Anëtarët dhe kryetari i Komisionit të Apelimit marrin shpërblim, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose

komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdhri i Mjekëve dhe të gjitha institucionet shëndetësore publike e jopublike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË
Nr. 47/5, datë 6.2.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Rikonstruksion i rrugës kthesa e Pashallisë-Konzibaltë deri në Konzibaltë", Bashkia Dimal

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Dimal.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vërë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "arë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 483,626.70 (katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pikë shtatëdhjetë lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION I RRUGËS KTHESA PASHALLISË – KONZIBALTË DERI NË KONIZBALTË

NR.	TË DHËNA HIPOTEKORE												VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM											SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
													ARË			TRUALL			NDËRTESË			Vlerat e kultura bujqësore dhe dru-frutorëve, sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		Vlera totale (lekë)			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose QYTETI	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e dru-frutorëve (lekë)			SEKSIONI D	SEKSIONI E
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z		
1	Andrea	Dude	Çepele	Konizbalte	2075	535/20	Arë	240	240			1	59	31	203	6,293									6,293	Konfirmuar nga ASHK-ja-ja		
2	Llambi	Bani	Nano	Konizbalte	2075	535/19	Arë	1000	1000			1	58	54	203	10,962									10,962	Konfirmuar nga ASHK-ja		Hiqet kufizimi
3	Vangjel	Llazi	Kumaraku	Konizbalte	2075	535/18	Arë	3640	3640			1	57	463.8	203	94,151									94,151.40	Konfirmuar nga ASHK-ja		
4	Robert	Stavri	Strori	Konizbalte	2075	535/17	Arë	3424	3424			1	56	256	203	51,968									51,968			
5	Sotiraq	Stavri	Strori	Konizbalte	2075	535/16	Arë	1630	1630			1	55	96	203	19,488									19,488	Konfirmuar nga ASHK-ja		
6	Kristo	Stavri	Strori	Konizbalte	2075	535/15	Arë	1200	1200			1	54	127	203	25,781									25,781	Konfirmuar nga ASHK-ja		
7	Stavri Kostandina	Kristo Andon	Strori Strori	Konizbalte	2075	535/30	Arë	100	100			6	93	104.6	203	21,233.8									21233.8	Konfirmuar nga ASHK-ja		
8	Kristo	Stavri	Strori	Konizbalte	2075	535/12	Arë	1740	1740			1	51	165	203	33,495									33,495	Konfirmuar nga ASHK-ja		
9	Xhevriko	Mesut	Danushi	Konizbalte	2075	535/11	Arë	1590	1590			1	50	57	203	11,571									11,571	Konfirmuar nga ASHK-ja	Shoqëria TAP AG gëzon të drejtën e servitutit të përhershëm për sipërfaqe 453 m^2	
10	Ngjeli	Toli	Komini	Konizbalte	2075	535/10	Arë	2856	2856			1	49	88.6	203	17,986									17,986	Konfirmuar nga ASHK-ja	Shoqëria TAP AG gëzon të drejtën për një ndryshim në kontratën e servitutit të përhershëm me sipërfaqe 213 m^2	
11	Perparim	Isa	Fisheku	Konizbalte	2075	535/28	Arë + Truall	2740	2540	200	81	6	56	69.7	203	14,149									14,149	Konfirmuar nga ASHK-ja		
12	Vasil	Jorgji	Naska	Konizbalte	2075	535/26	Are	400	400			6	15	58	203	11,835									11,835			
13	Llazar	Jorgji	Naska	Konizbalte	2075	535/27	Kullotë	2742	2606.1	135.9	135.9	6	16	72.6	111	8,059									8,059			Fshihet kufizimi me nr. dok. 0711, regjistrohet leja e legalizimit

14	Theodhor	Jorgji	Naska	Konizbalte	2075	535/5	Arë + truall	4475	4275	200	81	1	44	124.6	203	25,294									25,294	Konfirmuar nga ASHK-ja		
15	Mina	Llukan	Naska	Konizbalte	2075	535/4	Arë + truall	3306				1	43	119	203	24,157									24,157			Kufizohen veprimet deri në konfirmimin e AMTP, AMPT pa vulë dhe firmë
16	Fani	Llazar	Çomeni	Konizbalte	2075	535/3	Arë	2980	2980			1	42	162	203	32,886									32,886			Mbi këtë pasuri ka 1 ndërtim pa leje me sip. 85 m²
17	Nikollaq	Sotir	Naska	Konizbalte	2075	535/2	Arë	2495	2495			1	41	133.4	203	27,080									27,080		Në këtë pasuri është ngritur ndërtesa nr. 535/2-nd., vol 7, f. 150 me pronar Altin Naska dhe Nikollaq Naska	
18	Vasil	Laske	Garuli	Konizbalte	2074	535/1	Arë	1979	1979			1	40	117.7	203	23,893									23,893	Konfirmuar nga ASHK-ja		
	Arben	Kici	Vogli	Konizbalte	2075	539/20	Arë	3570	3570			1	158	115.0	203	23,345									23,345	Konfirmuar nga ASHK-ja		
19	Shtet			Konizbalte	2075	535/44	Kullotë	1238.4	1238.4					73	203	-												
20	Shtet			Konizbalte	2075	535/25	Arë	240	240					325	203	-											Në këtë pasuri ka një ndërtim pa leje, është e okuopuar nga z. Themi Çepele	
	SHUMA															483,626.70									**483,626.70**			

KËRKESË
Nr. 223/4, datë 6.2.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 397, datë 13.5.2020, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore, loti III", i ndryshuar, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 8,522,574.60 (tetë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar (në vijim "ARRSH").

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

a) Për pasuritë e llojit "ndërtesë", është bërë bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, i ndryshuar, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit "ndërtesë banimi ose jo banimi", i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë ARRSH-së, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 8,522,574.60 (tetë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE, LOTI 3", I NDRYSHUAR, TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË										SHËNIME
								Shpronësim tokë arë			Shpronësim tokë truall				Ndërtesë banimi (shtëpi)			
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m^2)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/ m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. ndërt. konf. ZVRPP-së (m^2)	Çmimi mes. sh/blerjeve sipas ZVRPP-së (l/m^2)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	
1	NAIM	FERID	HOXHA	8170	10/243	TRUALL	140.7				140.7	32878	**4625934.6**	45.1	86400	**3896640**	**8,522,574.60**	**L. leg. me nr. 2623751, datë 28.2.2017, godinë banimi 1-katëshe, sip. e katit përdhes =38.2 m^2, sip. verande=6.9m^2.**
Shuma													**4,625,934.60**			**3896640**	**8,522,574.60**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/02/10 15:49:52 +02'00'
ad5f3e7ea6e84534a827ccd652d23824202502101
5494484031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)